



A.nr.250/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.250/2026, të datës 05.03.2026, të parashtruar nga ankuesi K.A, nga Mitrovica, kundër organit të punësimit/Mitrovicës Veriore, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në senacën për këshillim dhe votim të datës 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.250/2026, e datës 05.03.2026, e parashtruar nga ankuesi K.A.
- II. Anulohet** Vendimi me numër protokolli 01-030/01-0002207/26, i datës 11.02.2026, i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore.
- III. Obligohet** Udhëheqësit i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Mitrovicës Veriore, që masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi ta largoj nga dosja personale e ankuesit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra, ne fat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, K.A (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 05.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 01-030/01-0002207/26, të datës 11.02.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, për shqiptimin e masës disiplinore “vërejtje me shkrim”, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të drejtës materiale dhe shkelje procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës Veriore, ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokoli 1147/2026 të datës 05.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Postimin e datës 21.12.2025 në Facebook të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 03.12.2025 për ankuesin; Vendimin e datës 10.07.2022 për konfirmimin e vazhdimin të marrëdhënies së punës për ankuesin; Akt Emërimit të datës 29.01.2025 të ankuesit; Përshkrimin e punës për Inspektor i Komunikacionit; Vendimit me numër protokoli 01-030/01-0002207/26, të datës 11.02.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, për shqiptimin e masës disiplinore “vërejtje me shkrim”; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 24.03.2026.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse:*

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokoli 01-030/01-0001082/25, të datës 25.01.2025, mbanë pozitën e punës *Inspektor i Komunikacionit*, në Komunën e Mitrovicës Veriore.
- Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, më Vendimin me numër protokoli 01-030/01-0002207/26, të datës 11.02.2026, ndaj ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje me shkrim”, me arsyetimin se i njëjti si nëpunësi i Komunës së Mitrovicës Veriore, ka shprehur bindjet partiake, ashtu që, përmes rrjetit social Facebook ka publikuar një fotografi më datë 21.12.2025, duke i uruar Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut zgjedhjen e tij si kryetar, me ç’rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti sipas këtij postimi paraqitet si përfaqësues i Komunës së Mitrovicës Veriore e sipas legjislacionit komunën e përfaqëson vetëm Kryetari, kështu që ka bërë shkelje të nenit 56 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të këtij ligji.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton Vendimin më numër protokoli 01-030/01-0002207/26, të datës 11.02.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, më pretendimin se akti i është përfshirë në shkelje procedurale dhe materiale sepse arsyetimi i këtij vendimi është absurd për shkak që në nuk kam bërë asnjë aktivitet politik dhe nuk ka promovuar asnjë subjekt politike dhe aspak verimet nuk bien ndesh me nenin 25 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08.L-197 për Zyrtarët Publikë. Interpretimi i nenit 25 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës veriore është bërë në mënyrë të gabueshme dhe me qëllim të dëmtimit sepse në këtë rast nuk ka asnjë shkelje disiplinore nga ana e ankuesit. Andaj, vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi sepse nuk plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës disiplinore për faktin se në rastin konkret nuk është përfaqësuar institucioni ku punoj sepse nuk ka qenë aspak takim zyrtar, e për rrjedhojë vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, si i tillë plotëson kushtet e paligjshmërisë së aktit administrativ. Kërkon që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë dhe të

obligohet Kryetari i Komunës të zbatoj këtë vendim dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të largoj masën disiplinore nga dosja personale.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, (me tej LZP) me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Neni 56, paragrafi 1, 3 dhe 4: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.*

- Nenit 57 paragrafi 1, ku përcaktohet: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim.*

Kolegji i Këshillit referuar kuadrit ligjor si më sipër, si dhe në mbështetje të nenit 86 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka analizuar aktin e kontestuar në ndërlidhje me provat materiale të lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankuesi më datë 21.12.2025 kishe postuar në profilin e tij të rrjetit social Facebook, një fotografi me kryetarin e sapo zgjedhur të Komunës së Mitrovicës së Jugut, më tekstin : *Së bashku me inspektorët e Komunës së Mitrovicës së Veriut, i uruam kryetarin të komunës, z. Faton Peci, marrjen e detyrës, e cila përfaqëson një nga përgjegjësit më të mëdha institucionale. Shprehëm*

gatishmërinë tonë për të ofruar mbështetje edhe në të ardhëm, në çdo iniciativë të mirë që do të ndërmerret për qytetin e Mitrovicës. Gjithashtu, morëm mbështetje të plotë dhe inkurajim nga kryetari, i cili vlerësoi punën që kemi bërë deti më tani dhe atë që vazhdojmë të bëjmë, si shërbim për krijimin e një mjedisi më të sigurt për secilin banor të komunës sonë, ndërsa, shqiptimi i masës së kontestuar ishte bazuar në këtë postim me arsyetimin së ankuesi më këtë postin ka shprehë bindje politike duke vepruar në kundërshtim më nenin 25 të LZP-së.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se zyrtari publik/nëpunësi civil ka përgjegjësi dhe detyrim ligjor që të përmbahet nga çdo veprim që bie ndesh më Kodin e Etikës së nëpunësit civilë, përfshirë edhe veprimet lidhur më pjesëmarrje në aktivitete politike në kundërshtim më dispozitat ligjore, mirëpo, në rastin konkret, Kolegji fillimisht konstaton së publikimi i postimit të datës 21.12.2024, nuk përben aktivitet politik, përmbajtja e postimit nuk ka elemente të shprehjes se ndonjë bindje politike për ndonjë subjekt të caktuar politik dhe se postimi në fjalë ishte bërë në ditë vikendi (ditë e diele), e që, mbi këto fakte, veprimet e ankuesit nuk bien ndesh më nenin 25 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: *1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik.*

Kolegji i Këshillit po ashtu konstaton se është fakt i pakontestueshëm së publikimi i datës 21.12.2025, ishte bërë mbi shprehjen duke aluduar që vizita ishte bërë nga pozita e inspektoreve të komunës së Mitrovicës Veriore, e jo nga roli i qytetarit, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit një veprim i tillë nuk mund të cilësohet si veprim i shprehjes së bindjeve politike në kundërshtim më dispozitat ligjore, por një veprim i tillë tërheq vërejtje për zyrtarët publikë në këtë rast edhe ankuesin, se duhet të kenë parasysh që postimet e tyre lidhur me aktivitete private të jenë në emrin e tyre e jo të pozitës zyrtare.

Andaj, nisur nga gjetjet dhe konstatimet si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin së në veprimet e ankuesve nuk manifestohet elementet e shkeljes së nenit 25 paragrafi 1 të LZP, kështu që, një akt administrativ i nxjerrë me vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, cilësohet si akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si pasojë, Kolegji, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.250/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit K.A;
- Komunës së Mitrovicës Veriore: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së